

SEKSIONI VI

PRODUKTET E INDUSTRIVE KIMIKE APO TË INDUSTRIVE TË LIDHJEVE

Shënime

1. (A) Mallrat (përveç xeheroreve radioaktive) që i përgjigjen një prej përshkrimeve të kreut 2844 apo 2845 do të klasifikohen në këto krerë dhe në asnjë kre tjetër të Nomenklaturës.
(B) Nënshtruar ndaj paragrafit (A) më lart, mallrat që i përgjigjen një prej përshkrimeve të kreut 2843, 2846 apo 2852 do të klasifikohen në këto krerë dhe në asnjë kre tjetër të këtij Seksioni.
2. Nënshtruar ndaj Shenimit 1 më lart, mallrat e klasifikueshme në kreun 3004, 3005, 3006, 3212, 3303, 3304, 3305, 3306, 3307, 3506, 3707 apo 3808, për arsye të vendosjes në doza të caktuara apo për shitjen me pakicë do të klasifikohen në këto krerë dhe në asnjë kre tjetër të Nomenklaturës.
3. Mallrat e vendosura në një grup që përbëhen nga dy apo më shumë përbërës të ndashëm, disa apo të gjithë të së cilës futen në këtë Seksion dhe që janë të destinuara për tu përzier së bashku për të fituar një produkt të Seksionit VI apo VII, do të klasifikohen në kreun e përshtatshëm për atë produkt, me kusht që përbërësit të jenë:
 - (a) për sa i përket mënyrës në të cilën ato janë vendosur, të identifikueshëm qartë që janë të destinuar për tu përdorur së bashku pa qenë me parë të ripaketuar;
 - (b) të paraqitur së bashku; dhe
 - (c) të identifikueshëm që janë plotësues të njëri-tjetrit, si nga natyra edhe nga raportet relative në të cilat ato janë paraqitur.